



Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”
Programe Specializimi Afatgjatë në Fushën e Mjekësisë

Shpallje Konkursi
Edicioni VII, Viti Akademik 2024-2025
Tiranë

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” (referuar në vijim UniKZKM), themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 567, më datë 27.08.2004, në bashkëpunim didaktik me Universitetin e Romës “Tor Vergata”, hap për vitin akademik 2024-2025, në vijim të miratimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë, në vijim të Urdhrit Nr. 664, të datës 28.12.2017 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, Specializime afatgjata pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, të Urdhrit Nr. 678, të datës 29.12.2017 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, Specializime afatgjata pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, të Urdhrit Nr.382, të datës 25/07/2024 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, Specializime afatgjata pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, të Urdhrit Nr.276 të datës 05/06/2024 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, Specializime afatgjata pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, të Urdhrit Nr.404 të datës 01/08/2024 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, Specializime afatgjata pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, dhe të Urdhrit Nr.412 të datës 01/08/2024 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, Specializime afatgjata pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, programe Specializimi afatgjatë në fushën e Mjekësisë, të Ciklit të III-të, për të diplomuarit në Mjekësi dhe Kirurgji të cilët kanë për qëllim zhvillimin e kompetencave specifike për ushtrimin e aktiviteteve mjekësore të specializuara në funksion të formimit profesional.

Neni 1 – Objektivat formues

Të diplomuarit në programet e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë duhet të kenë:

- përgatitje të mirë profesionale dhe aftësi metodologjike, kulturore dhe profesionale të avancuara, të përshtatshme për të analizuar, interpretuar, vlerësuar dhe menaxhuar problematikat e specializuara mjekësore-kirurgjikale;
- njohuri ndërdisiplinore për të planifikuar dhe zbatuar strategji të vepruari për menaxhimin e problematikave të natyrës shëndetësore me kompleksitet të lartë, aftësi për t’u integruar në tregun e punës të sistemit shëndetësor kombëtar dhe ndërkombëtar;

Neni 2 – Mundësitë e punësimit

Të diplomuarit në programet e specializimeve afatgjata, kanë mundësi punësimi të ndryshme dhe ushtrimin e aktiviteteve profesionale të specializuara në qendra shëndetësore publike dhe private ku kryhen veprimtari si diagnostikimi, përkujdesja, programimi dhe kërkimi shkencor në fushën e shëndetësisë (poliklinika, spitale, poliambulatorë, kompani farmaceutike, institute të sigurimit shëndetësor etj.) në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 3 –Mësimdhënia, Praktikat dhe Stazhet

Për qëllimet e mësipërme, kurrikula e programeve të Specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, lidhur me objektivat specifike të trajnimit, parashikon aktivitete mësimore dhe praktike klinike. Këto aktivitete do të rakordohen në bashkëpunim dhe partneritet me spitalet publike dhe private sipas marrëveshjeve të posaçme, në përputhje me Marrëveshjen e nënshkruar mes UniKZKM-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë Shqiptare.

Universiteti nuk do të nënshkruajë asnjë kontratë lidhur me shpërblime të mundshme për specializantin.

Neni 4 -Kriteret për pranim

Mund të marrin pjesë në provën përzgjedhëse shtetas të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të vendeve JO anëtare të Bashkimit Evropian që kanë:

- Diplomë Master i integruar i Shkencave në Mjekësi dhe Kirurgji/Mjekësi e Përgjithshme, ligjërisht e akredituar në momentin e lëshimit dhe e njohur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
 - Diplomë Master i integruar i Shkencave në Mjekësi dhe Kirurgji ose Farmaci për kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në përzgjedhjen për tu regjistruar në programin e Specializimit afatgjatë në Shkencat e të Ushqyerit;
 - Diplomë Master i integruar i Shkencave në Mjekësi dhe Kirurgji/ Mjekësi e Përgjithshme ose në Odontoiatri dhe Protezë Dentare për kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në përzgjedhjen për tu regjistruar në programin e Specializimit afatgjatë në Kirurgji Maxillo-Facciale;
- Të kenë licencë për të ushtruar profesionin e Mjekut Kirurg / Mjekut të Përgjithshëm (Certifikatë të Provimit të Shtetit dhe Vërtetimi i Regjistrimit në Urdhrin e Mjekut);
- Kandidatët që nuk janë pajisur me licencën e ushtrimit të profesionit të Mjekut Kirurg / Mjekut të Përgjithshëm mund të aplikojnë dhe, në rast se rezultojnë fitues, do të pranohen me rezervë. Ata duhet të marrin licencën e ushtrimit të profesionit brenda 3 muajve nga momenti i regjistrimit në Specializim në rast të kundërt përjashtohen nga Specializimi.
- certifikatë ndërkombëtare që vërteton nivelin B2 për një nga gjuhët (frënge, angleze, spanjolle, gjermane dhe italiane) sipas Dekretit të Ministrisë Nr. 10 të datës 16/06/2023. Kjo certifikatë nuk kërkohet për shtetasit e Bashkimit Evropian të cilët kanë kryer një cikël studimi në një nga gjuhët e sipërpërmendura.

Neni 5- Mënyra e Pjesëmarrjes

Çdo kandidat mund të konkurrojë maksimumi në dy Specializime të ndryshme duke përcaktuar qartësisht në kërkesën e pjesëmarrjes rendin e preferencës.

Për të paraqitur kërkesën për pjesëmarrje në seleksionim për pranimin në Programet e Specializimeve Afatgjata në Fushën e Mjekësisë, Cikli i III, kandidatët duhet të plotësojnë brenda datës **13 shkurt 2025, ora 23:59** procedurën e regjistrimit *online* në portalin e Universitetit Katolik ZKM <http://admissions.unizkm.al/> duke dërguar kopje elektronike në format PDF (skanim pdf/A) të dokumenteve të mëposhtme:

- Formular përshkrimi/Moduli A (i shkarkueshëm nga portali <http://admissions.unizkm.al/> ose nga ëësite [ëëë.unizkm.al](http://eëë.unizkm.al/) ;
- Diplomë dhe listë notash për çdo provim;
- Certifikata origjinale e diplomimit;
- Vërtetim i licencës për ushtrimin e profesionit të Mjekut Kirurg/Mjekut të Përgjithshëm (Certifikata e Provimit të Shtetit ose Vërtetimi i Regjistrimit në Urdhrin e Mjekut);
- Curriculum Vitae et Studiorum në gjuhën italiane ose angleze;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti);
- Tituj të tjerë të mundshëm dhe vërtetime (punime shkencore publikuar në revista të specializuara, certifikata për pjesëmarrje në projekte kërkimi, kurse perfeksionimi dhe specializimi, kurse gjuhe, Master, Doktorata etj.);
- Aftësi për të përdorur në mënyrë fluente si në formë të shkruar edhe me gojë gjuhën italiane dhe njohjen e njërës prej gjuhëve të mëposhtme: frëngjisht, anglisht, spanjisht, gjermanisht ose italisht të certifikuar në nivelin B2 të vërtetuar me certifikata ndërkombëtare sipas Dekretit të Ministrisë Nr.10 të datës 16/06/2023 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të II dhe të III në IAL” dhe sipas ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Vërtetim i pagesës së tarifës 100,00 Euro¹, si kontribut pjesëmarrjeje në seleksionim. Pagesa kryhet me kartë krediti në të njëjtin portal: <http://admissions.unizkm.al/> ose pranë Zyrës së Pranimeve në Universitetin Katolik ZKM, rruga “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri **brenda datës 11 shkurt 2025.**

Gjithashtu, pagesa mund të kryhet brenda të njëjtës datë edhe përmes filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë bankare me të dhënat e mëposhtme:

Përfituesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)

1. IBAN AL60208112040000030694935302 për pagesat në Euro;

2. IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.

¹ Komisionet e mundshme do t'i ngarkohen kandidatit. Pagesa e tarifës duhet të arrijë e plotë në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi nuk është i vlefshëm.

Në kryerjen e pagesës duhet të specifikohen emri dhe mbiemri si dhe emri i specialitetit për të cilin kryhet pagesa. Pas pagesës procedohet me kontrollin e dokumenteve për secilin kandidat. Statusi i regjistrimit mund të verifikohet duke hyrë hapësirën e rezervuar në portalin e Universitetit.

Neni 6 -Mënyra e seleksionimit

Kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në provimin përzgjedhës për pranim duhet të paraqiten për të dhënë provimin e pranimit të pajisur me një dokument identifikimi të vlefshëm në auditorët e Universitetit Katolik ZKM në rrugën “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri.

Provimi me shkrim do të kryhet në orën 11:00 në datë 25/02/2025.

Provimi me gojë do të kryhet në orën 15:00 në datë 25/02/2025.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një Komision i emëruar me një dekret të Rektorit që do të vlerësojë titujt e diplomave të paraqitura dhe rezultatet e provimeve.

Konkursi konsiston në një provim me shkrim dhe një provim me gojë. Provimi me shkrim do të fokusohet në tema të mjekësisë së përgjithshme. Provimi me gojë do të konsistojë në diskutimin e kandidatit me Komisionin për temat e kulturës së përgjithshme mjekësore, duke iu referuar edhe atyre të përfshira në provimin me shkrim, si dhe tema që i përkasin fushës së specializuar për të cilën kandidati konkurron.

Për provimin me shkrim, Komisioni do të aplikojë 60 pyetje me shumë përgjigje (quiz) dhe me kohë në dispozicion 60 minuta.

Konsultimi i asnjë teksti nuk lejohet gjatë testimit me shkrim, në të kundërt përjashtohet nga konkursi.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga Komisioni nëpërmjet një provimi konkurrimi, i cili parashikon një sistem vlerësimi me në total 100 pikë të ndara si më poshtë:

1. 60 pikë – provimi me shkrim;
2. 10 pikë – provimi me gojë
3. 10 pikë – vlerësimi i titujve
4. 20 pikë – nota mesatare e ponderuar për kandidatët që kanë një diplomë Shqiptare dhe për kandidatë që kanë një diplomë të huaj.

Për të marrë pjesë në Konkursin e Specializimit, kandidatët e diplomuar në Shqipëri duhet të kenë një mesatare të ponderuar të notave të të gjitha viteve të Programit të Studimit në Mjekësi, jo më të ulët se 5 (pesë).

Në rast *ex-aequo* kanë përparësi ata që kanë marrë pikë më të larta në provën e pranimit me shkrim.

Në programin e Specializimit do të pranohen kandidatët të cilët do të renditen fitues në listën e hartuar në bazë të rezultatit të përgjithshëm të pikëve të grumbulluara, në përputhje me numrin e kuotave në dispozicion.

Renditja zyrtare do të publikohet brenda datës **28/02/2025** në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM <https://ëëë.unizkm.al/> dhe në Sekretarinë Mësimore të Programit të Mjekësisë dhe Kirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

Neni 7 – Mënyra e regjistrimit në Programin e Specializimeve

Kandidatët fitues duhet të depozitojnë pranë Sekretarisë mësimore të Mjekësisë dhe Kirurgjisë brenda datës **10/03/2025** kërkesën për regjistrim detyrimisht të plotësuar dhe nënshkruar (sipas formularit që gjendet pranë Sekretarisë ose që mund të shkarkohet nga portali i studentit <https://portal.unizkm.al/#/>);

- fotokopje autentike e diplomës dhe listës së notave për çdo provim;
- fotokopje autentike e Certifikatës së diplomimit
- fotokopje autentike e vërtetimit të licencës për ushtrimin e profesionit të Mjekut Kirurg/Mjekut të Përgjithshëm (Certifikata e Provimit të Shtetit ose Vërtetimi i Regjistrimit në Urdhrin e Mjekut);
- Curriculum Vitae et Studiorum në gjuhën italiane ose angleze;
- fotokopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti);
- tituj të tjerë të mundshëm dhe vërtetime (punime shkencore publikuar në revista të specializuara, çertifikata për pjesëmarrje në projekte kërkimi, kurse perfeksionimi dhe specializimi, kurse gjuhe, Master, Doktorata etj.);
- fotografi
- vërtetimin e pagesës së tarifës vjetore si kontribut për studimet e barabartë me 3000 € për shtetasit shqiptar për tu paguar me një kësht të vetëm ose me dy kështe nga 1500 €, i pari në momentin e regjistrimit dhe i dyti brenda datës 30/09/2023; 4500 € për shtetasit e huaj të vendeve anëtare të BE si dhe jo anëtare të BE, e cila duhet paguar e gjitha në momentin e regjistrimit.

Për vitet e ardhshme, tarifat e sipërpërmendura paguhen përkatësisht në 30 mars të çdo viti në një kësht të vetëm për shtetasit e huaj të vendeve anëtare apo jo të BE-së, ndërsa për shtetasit shqiptar kështin e parë në 30 mars të çdo viti dhe kështin e dytë në 30 shtator.

- vonesat në pagesën e kështeve ose kështit të vetëm do të sjellin një kamatë vonesë sipas kushteve të mëposhtme:

Për tridhjetë ditët e para të vonesës:

* 100 Euro për kështin e parë apo për kështin e vetëm

* 30 Euro për kështet e tjera

Për vonesat e mëtejshme: 15 Euro për çdo muaj

Aplikimet me mangësi në dokumentacion nuk do të merren parasysh dhe sekretaria do të procedojë duke thirrur kandidatin pasardhës në renditjen sipas meritës.

Sekretaria nuk është përgjegjëse për vonesa në dorëzimin e dokumentacionit të paplotë.

Universiteti regjistron kandidatin me rezervë, deri në regjistrimin nga Qendren e Shërbimit Arsimor të Republikës së Shqipërisë (QSHA). Në rast refuzimi të regjistrimit për çfarëdo arsye që lidhet me mos përmbushjen e kërkesave nga kandidati, Universiteti përjashtohet nga çdo përgjegjësi.

Fituesit të cilët nuk kryejnë regjistrimin dhe pagesën brenda afatit të caktuar do të konsiderohet se kanë hequr dorë nga specializimi dhe do të zëvendësohen nga kandidatët pasardhës në renditje: për këta të fundit afati i regjistrimit është brenda datës së fillimit të programit.

Shënim: Kandidatët që janë diplomuar jashtë vendit duhet të kryejnë edhe procedurën e njehsimit të diplomës pranë Qendrës së Shërbimit Arsimor të Republikës së Shqipërisë (QSHA) dhe t'ia dorëzojë Sekretariatit Mësimor kopjen e dokumentit të njohjes së diplomës të lëshuar nga QSHA-ja.

Neni 8- Mënyra e zhvillimi të aktivitetit mësimor

Aktivitetet në lidhje me leksionet forntale do të zhvillohen në vendet e zgjedhura nga Universiteti. Aktiviteti akademik teorik/klinik-praktik do të zhvillohet në strukturat shëndetësore të vendosura paraprakisht me marrëveshje bashkëpunimi specifike të parashikuara në Marrëveshjen Kuadër nënshkruar mes UniKZKM dhe Ministrisë së Shëndetësisë Shqiptare dhe strukturave shëndetësore të cilat do të përcaktohen nga Përgjegjësit e secilit Program specializimi sipas nevojave të posaçme të vet specializimit.

Praktikat klinike do të kryhen në strukturat shëndetësore të palëve partnere me të cilat ka marrëveshje. UniKZKM, në fillim të programit, do t'i komunikojë në kohë përmes Përgjegjësve të Programeve, çdo kandidati fitues emrin e udhëheqësit dhe të strukturës shëndetësore ku do të kryhen aktivitetet klinike-praktike.

Neni 9– Lista e programeve të specializimit të hapura dhe numri i kuotave përkatëse për secilin program

Nr.	Program Specializimi në:	Kuota	Kohëzgjatja
1	Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive	4	5 vjet
2	Kirurgji e Përgjithshme	4	5 vjet
3	Gastroenterologji	2	4 vjet
4	Gjinekologji dhe Obstetrikë	3	5 vjet
5	Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular	4	4 vjet
6	Nefrologji	2	5 vjet
7	Otopedi dhe Traumatologji	3	5 vjet
8	Shkencat e të Ushqyerit	2	4 vjet
9	Kirurgji Plastike, Rikonstruktive dhe Estetike	4	5 vjet
10	Kirurgji Maksilo-Faciale	4	5 vjet
11	Urologji	4	5 vjet
12	Otorinolaringoiatri	4	5 vjet

Rektori
Prof. Leonardo Palombi

Tiranë më, 10/01/2025

